# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 15/198**
**Datë: 02.04.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-198 për Tregtinë me mallra strategjike, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet përditësimi i Listës Shtetërore Strategjike për Mallra me Përdorim të Dyfishtë, duke iu referuar Listës së Bashkimit Evropian, për mallrat që vihen nën kontroll për shkaqe të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, sigurisë publike ose për arsye të drejtave të njeriut, në përputhje me Rregulloren e deleguar të komisionit të BE-së 2023/2616 të datës 15 shtator 2023, duke ndryshuar Rregulloren e BE-se 2021/821 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian.

2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatim te këtij Vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada – Government***

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

# PROJEKT KONCEPT DOKUMENTI PËR PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE (PMB)

Prishtinë 2024

Hyrje ........ 3
**Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit** ........ 5
**Toka bujqësore** ........ 6
**Madhësia e fermës** ........ 6
**Inputet në bujqësi** ........ 7
**Përshkrimi i politikës dhe kornizës ligjore ekzistuese** ........ 9
**Problemi kryesor, shkaqet dhe palët e interesuara** ........ 15
Kapitulli 2: Objektivat ........ 23
**Kapitulli 3: Opsionet** ........ 31
**Mangësitë e identifikuara në sektorin e PMB-ve mund të adresohen me tre opsione të ndryshme:** ........
**3.1: Opsioni asnjë ndryshim** ........ 31
**3.2. Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit** ........ 31
**3.3. Opsioni i tretë me ndryshime** ........ 32
**Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme** ........ 36
**Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi** ........ 43
**Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve** ........ 44
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme ........ 45
**Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me tri opsionet** ........ 54
**Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm** ........ 56
**Baza për hartimin e Legjislacionit** ........ 57
**Vlerësimi i ardhshëm** ........ 58
Shtojca 1: Formulari i vlerësimit të ndikimit ekonomik ........ 59
Shtojca 2: Formulari i vlerësimit të ndikimit social ........ 65
Shtojca 3: Formulari i vlerësimit të ndikimit në mjedis ........ 71
Aneksi 4: Formulari i vlerësimit të ndikimit për të drejtat themelore ........ 76

**Hyrje**

*Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin*

| Titulli | **Koncept Dokumenti për Produkte për Mbrojtjen e Bimëve** |
|---|---|
| Ministria bartëse | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural<br>Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje<br>Divizioni i Mbrojtjes së Bimëve |
| Personi kontaktues | Selvije Blakaj- Gashi 038/ 200 38 835 ; 044/ 430 737 |
| **Plani Kombëtar për Zhvillim** | **Qëllimi zhvillimor dhe qëllimi strategjik:**<br>• **1.9 Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme në mes të fermerëve, përpunuesve dhe shitësve me pakicë;**<br>• **Masa Strategjike: Përmbushja e kërkesave për ushqimin të sigurtë dhe të shëndetshëm;**<br>• **Aktivitideti- Hartimi i Koncept Dokumentit për Produktet për Mbrojtjen e Bimëve.** |
| Prioriteti strategjik | • Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025<br>2.10. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural;<br>2.10.1 Reformat gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për shërbime më efikase;<br>2.10.2. Rritja e konkurrencës në sektorin agro-ushqimor;<br>2.10.5 Siguria e ushqimit.<br>**Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030**<br>**Shtylla e I – Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik;**<br>**Qëllimi Zhvillimor: Ekonomi digjitale, qarkore dhe konkurruese;**<br>**Qëllimi Strategjik: 1.9 Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme mes fermerëve, përpunuesve e shitësve me pakicë.**<br>**Objektivi strategjik:**<br>Avancimi i politikave për siguri ushqimore dhe përafrimi i tyre me standardet e BE-së, të cilat synojnë të sigurojnë një nivel të lartë të ushqimit për njeriun dhe shëndetin e bimëve nga përdorimi i qëndrueshëm i produkteve për mbrojtjen e bimëve. |

| | |
|---|---|
| | **Objektivat specifike:**<br><br>- Regjistrimi, importimi, ruajtja dhe vendosja në treg e PMB-ve të bëhet sipas legjislacionit të BE-së;<br><br>- Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit për PMB-të dhe inspektimit pas regjistrimit;<br><br>- Mbrojtja e fermerëve vendor nga importimi dhe tregtimi i PMB-ve jo cilësore dhe ngritja e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë e PMB-ve;<br><br>- Krijimi i sistemit për trajnime të detyrueshme për përdoruesit profesional të PMB-ve;<br><br>- Pajisjet për përdorim profesional për aplikimin e PMB-ve, të regjistrohen dhe të inspektohen në intervale të rregullta, në mënyrë që të arrihet niveli i lartë i mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe mjedisit. |
| Grupi punues | Me Vendimin Nr.120 Ref. ZSP 150/23 i datës 28.02.2023, Sekretari i Përgjithshëm i MBPZhR-së emëron Grupin Punues për hartimin e Koncept Dokumentit për Produkte për Mbrojtjen e Bimëve:<br>Selvije Blakaj Kryesuese; Shaban Hamzaj, zv.kryesues; Isah Rudaku; Arian Bugari; Arnesa Ferizi; Veton Çoçaj; Leonora Arifi; Merita Ramaxhiku; Albulena Blaku; Naim Delijaj; Ekrem Ahmeti; Valbona Fetahu; Arben Mehmeti. |
| Informata shtesë | Republika e Kosovës në proceset integruese në BE është zotuar dhe ka marrë të gjitha obligimet në përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit dhe politikat zhvillimore, që kanë të bëjnë me shëndetin e njeriut, kafshëve dhe bimëve në zinxhirin agro-ushqimorë që janë fundamentale për shëndetin e konsumatorit, zhvillimin ekonomik të vendit dhe mbrojtjen e mjedisit.<br><br>Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian i vitit 2022 citon:<br><br>'Të sigurojë me kohë mjetet dhe burimet e nevojshme për funksionimin efektiv të Sistemit të Menaxhimit të Kontrollit të Ushqimit dhe Gjurmueshmërisë dhe Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Laboratorik të zhvilluar me mbështetjen e BE-së, pasi ato janë të rëndësishme në sigurimin e pajtueshmërisë së produkteve ushqimore të prodhuara ose të tregtuara nga Kosova me sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe standardet e shëndetit të bimëve, që janë parakusht për një sektor konkurrues agro-ushqimor.<br><br>→ Të zgjedhë operatorin për menaxhimin e impiantit depozitues dhe sistemin e grumbullimit të nënprodukteve bimore dhe të fillojë me funksionimin e impiantit depozitues''. |

## Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Koncept Dokumenti ka për qëllim të adresojë çështjet, të cilat nuk kanë qenë të përfshira me rregullativën aktuale ligjore të PMB-ve. Gjatë viteve të fundit është arritur një përparim i kënaqshëm sa i përket përdorimit të PMB-ve, megjithatë mungesa e kontrollit të PMB-ve të ndaluara, mbetjet e PMB-ve në produkte bimore dhe ndotja mjedisore janë problemet që duhet adresuar në të ardhmen.

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë, është i varur shumë nga përdorimi i PMB-ve, prandaj përdorimi i PMB-ve ka një rolë të rëndësishëm për arritjen e synimeve strategjike të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës duke përfshirë edhe sigurimin e ushqimit.

Për përdorimin e PMB-ve në bujqësi intensive, janë të rëndësishme: autorizimi, vendosja në treg, qarkullimi, përdorimi, mbetjet në bimë dhe produkte bimore, mbajtja e regjistrit për persona fizik dhe juridik të përfshirë për vendosjen në treg dhe pajisjet për aplikim, prodhimi dhe paketimi i PMB-ve dhe licencimi i personave profesional për përdorim të PMB-ve.

Kjo do të mundësojë rritjen e prodhimit vendor të produkteve bujqësore dhe përmirësimin e kushteve ekonomike dhe sociale të fermerëve.

Koncept Dokumenti ka për qëllim të adresojë çështjet, të cilat kanë munguar sa i përket vendosjes në treg dhe kontrollimin e substancave aktive të PMB-ve, prodhimin dhe paketimin e PMB-ve dhe licencimin e personave profesional për përdorim të PMB-ve.

Sfidat kryesore për tregtimin dhe përdorimin e drejtë të PMB-ve:

- Tregtia e paligjshme, e pa kontrolluar, për PMB-të;
- Mungesa e infrastruktures adekuate për analizë dhe testim të produktit dhe materies aktive;
- Mungesa e analizave të mbetjeve të produkteve për MB-të në bimë dhe produkte bimore;
- Mungesa e regjistrimit të shërbimeve profesionale, numrit të pajisjeve për përdorim profesional të PMB-ve, si dhe testimi i tyre.

### Toka bujqësore

Bazuar nga Anketa e Ekonomive Bujqësore, gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ka pasur një trend të përafërt të shfrytëzimit në periudhën kohore 2017-2021. Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore në vitin 2021 ishte 420,327 ha, që ishte sipërfaqe e përafërt me atë të vitit 2020. Sipërfaqja mesatare e tokës së shfrytëzuar bujqësore për Ekonomi Bujqësore ishte 3.2 ha. Ekonomitë familjare kanë rreth 2-5 ha të sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore, e që përbëjnë rreth 23.3% të sipërfaqës së përgjithshme. Numri i Ekonomive Bujqësore në Kosovë është 130 775. Sipas të dhënave të pranuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), toka bujqësore e privatizuar deri më tani është përafërsisht 30,217 ha. Ndërsa ka mbetur nën menaxhim të AKP-së përafërsisht rreth 40,000 ha tokë bujqësore.

**Shfrtyëzimi i tokës bujqësore sipas kategorive**

| | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 |
|---|---|---|---|---|---|
| Tokë e punueshme – ara | 186,954 | 188,359 | 188,365 | 188,372 | 188,375 |
| Perime, Kopshte dhe Fidanishte | 9,858 | 9,398 | 10,070 | 10,252 | 10,283 |
| Plantacione të pemëve | 6,247 | 7,687 | 9,244 | 10,029 | 10,144 |
| Plantacione të vreshtave | 3,199 | 3,272 | 3,367 | 3,437 | 3,471 |
| Livadhe dhe kullosa përfshir tokën e përbashkët | 218,314 | 218,152 | 217,932 | 217,102 | 217,107 |

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('17,'18,'19,'20, '21)

Përveç livadheve dhe kullosave me 217,107 ha, që përbën 51.7% të gjithsej sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore, pastaj janë tokat e punueshme, me pjesëmarrje prej 44.8%, që paraqet sipërfaqen prej 188,375 ha, ku përfshihet edhe sipërfaqja e perimeve në fushë të hapur (si kulturë e parë) (8,491 ha) dhe perimet në serra po ashtu si kulturë e parë (562 ha), pra gjithsej 9,053 ha me perime (Raporti i Gjelbër i Kosovës, MBPZHR 2022).

### Madhësia e fermës

Sipërfaqja e tokës së punueshme e shfrytëzuar i referohet sipërfaqes kryesore gjatë një viti të prodhimit bujqësor. Në vitin 2020, gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte

420,210 ha, nga kjo sipërfaqe gjithsej toka të punueshme-ara ishin 186,389 ha, apo 44% ku janë të përfshira 103,723 ekonomi bujqësore.

**Madhësia e ekonomive sipas sipërfaqes së tokës së punueshme, 2020**

| Madhësia e fermës | Sipërfaqja (ha) | Pjesëmarrja (%) | Nr. i Ekonomive Bujqësore | Pjesëmarrja (%) |
|---|---|---|---|---|
| 0 dhe më pak se 0.5 | 6,453 | 3.5 | 31,290 | 30.2 |
| 0.5 deri më pak se 1 | 11,999 | 6.4 | 17,560 | 16.9 |
| 1 deri më pak se 2 | 29,005 | 15.6 | 22,560 | 21.8 |
| 2 deri më pak se 5 | 38,665 | 20.7 | 23,383 | 22.5 |
| 5 deri më pak se 10 | 64,819 | 34.8 | 7,063 | 6.8 |
| 10 deri më pak se 20 | 16,800 | 9.0 | 1,429 | 1.4 |
| 20 deri më pak se 30 | 5,255 | 2.8 | 240 | 0.2 |
| 30 e më shumë | 13,393 | 7.2 | 198 | 0.2 |
| Gjithsej* | **186,389** | **100%** | **103,723** | **100%** |

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore 2020
*Nuk janë përfshirë EB të komunave veriore

Në Kosovë madhësia e fermës prej 5 deri më pak se 10 ha, përfaqëson 35% të gjithsej sipërfaqes së tokave të punueshme arave, pasuar nga madhësia e fermave prej 2 deri më pak se 5 ha (21%), madhësia 1 deri më pak se 2 ha (16%) dhe madhësitë e tjera me më pak pjesëmarrje ku madhësia me sipërfaqen më të vogël është ajo prej 0 deri më pak se 0.5 ha.

**Inputet në bujqësi**

Të dhënat lidhur me strukturën e konsumit të ndërmjetëm bujqësor për vitin 2021, shprehur në përqindje, tregojne se pjesëmarrje më të madhe në këtë strukturë paraqet kategoria e ushqimit të kafshëve, e cila përfshinë materialin ushqyes të cilin fermeri e blen nga fermerët tjerë apo lëndën e parë dhe ushqimin për kafshë që fermeri e prodhon në fermë, kontribuon me 51%, që paraqet gjysmën e konsumit të ndërmjetëm. Plehrat, përmirësuesit e tokës kanë pjesëmarrje prej 12%, shërbimet bujqësore 7%, mallrat dhe shërbimet tjera 9%, shpenzimet e energjisë 8%, farërat dhe materiali mbëltues 4%, shpenzimet veterinare 3%, mirëmbajtja e materialeve 3%, ndërsa PMB-të dhe mirëmbajtja e ndërtesave janë me pjesëmarrje më të ulët (Raporti i Gjelbër i Kosovës, MBPZHR 2022).

**Përdorim i PMB-ve**

Një ndër presionet kryesore të ndikimit në mjedis nga sektori i bujqësisë është përdorimi i PMB-ve, sipas të dhënave nga Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore për vitet 2015-2019 të realizuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, rezulton se në vitin 2015 janë trajtuar 115,083.40 ha me PMB, për të shënuar një rritje prej 3,967.53 ha të sipërfaqeve të trajtuara me pesticide në vitin 2019, me gjithsej 119,050.93 (Mjedisi i Kosovës 2020 - Raport i treguesve mjedisorë).

PMB-të kryesisht importohen nga subjektet vendore dhe që janë të autorizuara nga kompanitë prodhuese të PMB-ve. Në Kosovë PMB-të e importuara lejohen për përdorim dhe qarkullim vetëm nëse janë të regjistruara në një shtet anëtar të BE-së.

**Mbetjet e PMB-ve**

**Tabela 1: Marrja e mostrave dhe dërgimi i tyre në Laborator**

| Mostra të testuara - parametrat sipas tremujorve T1-T4 ( Janar –Dhjetor ) 2021 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Parametrat e analizuar | Numri i mostrave<br>T12021 | T22021 | T32021 | T42021 |
| Analiza fitopatologjike | 87 | 46 | 59 | 98 |
| Analiza entomologjike | 12 | 31 | 23 | 4 |
| Analiza në mbetje të PMB-ve | 25 | 78 | 21 | / |

Burimi: AUV, Raporti i Gjelbër i Kosovës, MBPZHR 2022

**Kontrolli i Cilësisë së PMB-ve**

Për momentin asnjë institucion nuk e kryen testimin e cilësisë (materie aktive dhe materie ndihmëse) dhe të efikasitetit së PMB-ve në vendin tonë. Të gjitha testimet bazohen në bazë të testeve që kryejnë kompanitë prodhuese në BE. Testimi fushor për efikasitet duhet të realizohet nga Insitutet e specializuara si Instituti Bujqësor i Kosovës dhe Universitetet që kanë programe specifike për Mbrojtjen e bimëve. Njëkohësisht për këtë qëllim inspektorët fitosanitarë duhet të kryejnë trajnime shtesë lidhur me marrjen e mostrave të produkteve bimore për analiza të mbetjeve të PMB-ve.

**Ofrimi i Shërbimeve Këshillimore të PMB-ve**

Është i organizuar në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvilllimit Rural (MBPZHR) dhe në nivel komunal, por i cili më tepër ka rol organizativ, përmes së cilit duhet të shperndahen të gjitha informacionet lidhur me përdorimin e drejtë të PMB-ve varësisht nga semundjet dhe demtuesit që paraqiten në kulturat e ndryshme bujqësore.

**Zhvillimi i institucioneve dhe kompanive të PMB-ve**

Institucionet kryesore që janë të përfshira lidhur me PMB-të (MBPZHR, MMPH, DPBT, IBK, AUV, Doganës, Kompanive Prodhuese të Farës dhe Fakulteteve të Bujqësisë) duhet forcuar bashkëpunimin në mënyrë që të prodhojmë produkte bujqësore sa më të sigurta për nevojat vendore dhe eksport.

**Përshkrimi i politikës dhe kornizës ligjore ekzistuese**

Korniza aktuale ligjore e Kosovës për Produktet për Mbrojtjen e Bimëve është rregulluar me Ligjin Nr. 03/L-042 për Produkte për Mbrojtjen e Bimëve, miratuar më 07 Nëntor 2008. Me akte nën ligjore, nga ky ligj janë rregulluar vendosja në treg dhe kontrollimi i substancës aktive të produkteve për mbrojtjen e bimëve, autorizimi, qarkullimi, përdorimi, klasifikimi, ambalazhimi dhe etiketimi. Që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Produkte për Mbrojtjen e Bimëve nuk ka pasur plotësime dhe ndryshime.

Marrë parasysh shëndetin e konsumatorit, zhvillimin ekonomik të vendit dhe mbrojtjen e mjedisit Parlamenti Evropian dhe Këshilli në Tetor të vitit 2009 miratuan Rregulloren (BE) 1107/2009, në lidhje me vendosjen në treg të produkteve për mbrojtjen e bimëve si dhe shfuqizimin e Direktivave të Këshillit 79/117/EEC dhe 91/414/EEC. Ligji për Produkte për Mbrojtje të Bimëve do të harmonizohet me Rregulloren (BE) 1107/2009. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë një nivel të lartë mbrojtjeje të shëndetit të njerëzve dhe kafshëve dhe mjedisit dhe të përmirësojë funksionimin e tregut të brendshëm nëpërmjet harmonizimit të rregullave për vendosjen në treg të produkteve për mbrojtjen e bimëve duke përmirësuar njëkohësisht prodhimet bujqësor.

Rekomandimet e ekspertëve të projektit të binjakëzimit

1. Ligjit Nr. 03 / L-042 "Për produktet e mbrojtjes së bimëve" dhe nën-aktet përkatëse për t'u përputhur plotësisht me Rregulloren (EU) Nr.1107 / 2009.

2. Vendosjen dhe zbatimin e niveleve maksimale të mbetjeve në ushqimin me origjinë bimore dhe shtazore.

3. Të rregullohet sistemi i trajnimit për përdorimin e sigurt të produkteve të mbrojtjes së bimëve për përdoruesit profesionistë, shpërndarësit dhe këshilltarët.

4. Plotesimi i bazës ligjore dhe të zbatojë një sistem për testimin dhe inspektimin e rregullt të pajisjeve për aplikimin e pajisjeve për mbrojtjen e bimëve.

5. Të zbatojë sistemin e kontrollit zyrtar në lidhje me përdorimin e produkteve të mbrojtjes së bimëve.

6. Të rregullohen procedurat e kontrollit të dokumenteve / listat kontrolluese dhe të kontrollojnë procedurat e verifikimit për vendosjen në treg dhe përdorimin e produkteve të mbrojtjes së bimëve.

**Tabela 2: Të dhënat sa i përket importit dhe Prodhimit të PMB-ve (në ton)**

| Importi dhe prodhimi i PMB-VE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Të dhënat për 4 vite | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | |
| Importi i PMB-ve | 683.70 | 920.40 | 674.00 | 684.00 | 2962.10 |
| Prodhimi i PMB-ve | - | - | - | - | 0 |
| Gjithsej ton | 683.70 | 920.40 | 674.00 | 684.00 | 2962.10 ton |

Në tabel pasqyrohen të dhënat sa i përket importit dhe prodhimit të PMB-ve për 4 vitet e fundit 2019-2022, dhe bazuar në të dhënat të cilat janë ofruar nga AUV- Inspektorati Fitosanitar, del se në mesatare cdo vit importohen 740.50 ton PMB, ndërsa deri më tani nuk ka të dhëna se ekziston ndonjë kompani e cila merret me prodhimin e PMB-ve.

Mënyra më e mirë për të përcaktuar mangësitë që dalin nga korniza aktuale ligjore e Kosovës është ta krahasojmë atë me kornizën e re ligjore të BE-së për PMB.

*Tabela 1: Dokumentet legjislative dhe politike dhe përgjegjësitë e institucioneve*

| Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor; | Lidhja (linku) me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare; | Institucioni (et) shtetëror (e) përgjegjës (e) për zbatim; | Roli dhe detyrat e Institucionit (eve); |
|---|---|---|---|
| Ligji Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve; | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2604; | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR);<br><br>Instituti Bujqësor i Kosovës ne Pejë (IBK);<br><br>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë/ (AUV); | Hartimi i politikave dhe legjislacionit për PMB-ve dhe zbatimit të Ligjit;<br><br>Analizimi i mostrave te marrura nga AUV;<br><br>Implementimin e legjislacionit primar dhe sekondar. |
| Ligji Nr.08/L-093 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve; | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62187 | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR);<br><br>Instituti Bujqësor i Kosovës në Pejë (IBK);<br><br>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë/ (AUV).<br><br>Institucionet | Lëshimi i lejeve për Personat përgjegjës për Barnatore Bujqësore dhe Masat ndëshkimore (harmonizimi i sanksioneve adminsitrativ); |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | kompetente gjyqësore-gjykatat. | |
| Udhëzim Adminsitrativ (MBPZHR)-Nr.09/2022 Për Mënyrën, Dinamikën e Kryerjes së Shërbimeve Profesionale, Metodën e Përcjelljes së Pëdorimit dhe Vlerësimin e Mjeteve për Përdorim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve; | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=65759 | MBPZHR<br>AUV<br>IBK; | Përcakton lëshimin e autorizimeve për trajnimin e përdoruesve profesionistë të produkteve për mbrojtjen e bimëve, shpërndarësve të produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe këshilltarëve të mbrojtjes së bimëve, dhe kërkesat për marrjen e autorizimit. |
| Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2017 për Ripaketimin e Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve; | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15171 | MBPZHR<br>AUV<br>IBK; | Përcakton kushtet, kriteret dhe procedurat për ripaketimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve që vendosen në tregun e Kosovës. |
| Udhëzim Administrativ (MBPZHR) – Nr. 17/2014 Për Klasifikimin, Ambalazhimin, Etiketimin Dhe Shoqërimin e | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10122 | MBPZHR<br>AUV<br>IBK | Përcakton kushtet, procedurat dhe mënyrat për klasifikim, ambalazhim, etiketimin dhe shoqërimin e produkteve për |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve; | | | mbrojtjen e bimëve. |
| Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 Për Ndryshim Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2010 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Nr. 09/2009 Autorizimi për Certifikim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve; | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8133; | MBPZHR<br>AUV | Rregullon Autorizimin për Certifikim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve; |
| Udhëzim Administrativ Nr. 02/2010 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin E Udhëzimit Administrativ Nr.09/2009 Autorizimi Për Certifikim Të Produkteve Për Mbrojtjen e Bimëve; | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7863 | MBPZHR<br>AUV<br>IBK | Përcakton Kërkesat për leje të personit përgjegjës në barnatore bujqësore; |
| Udhëzim Administrativ Nr. 13/2009 për Caktimin e Kushteve, Objekteve dhe Pajisjeve për Vendosjen në Treg të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve; | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7760 | MBPZHR<br>AUV<br>IBK | Përcakton kushtet e objekteve dhe pajisjeve për vendosje në treg të produkteve për mbrojtjen e bimëve si dhe rregullon klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin e produkteve për |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | mbrojtjen e bimëve. |
| Udhëzim Administrativ nr. 09/2009 Autorizimi për Certifikim të Produkteve për Mbrojtjen e bimëve; | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7708; | MBPZHR<br>AUV<br>IBK | Përcakton kushtet për autorizim të personave fizik dhe juridik që merren me importim, tregtim të produkteve për mbrojtjen e bimëve; |
| Ligji Nr.05/L-087 për Kundërvajtje (Gazeta Zyrtare nr.33/08/09/2016; | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12839 | Ministria e Drejtësisë MBPZHR; | Zbatojnë dispozitat ligjore ne fuqi; |
| Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare Nr.20/21.06.2016; | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559; | Ministria e Administratës Publike MBPZHR; | Zbatojnë dispozitat ligjore ne fuqi. |

**Situata në vendet e BE-së:**

**Tabela 2. Plani i kontrollit të mbetjeve të PMB-ve për vitin 2019-2021**

| Lloj i produktit | Malli | Numri i mostrave në 2019 | Numri i mostrave në 2020 | Numri i mostrave në 2021 |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| Produkte bimore | Patate | x | X | x |
| | Mjedra | x | X | x |
| | Gruri | x | X | x |
| | Këpurdha të egra | x | X | x |
| | | | | |
| Produkte shtazore | | | | |
| | | | | |

**Metoda analitike dhe siguria e cilësisë**

Mostrat do të analizohen në Institutin Bujqësor të Kosovës – Pejë (IBK) dhe laboratoret tjera të cilat janë të akredituara. Për momentin nuk janë të akredituara për analizë dhe testim të mbetjeve të PMB-ve në bimë dhe produkte bimore.

**Problemi kryesor, shkaqet dhe palët e interesuara**

**Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet**

| | |
|---|---|
| **Efektet** | **<u>Rregullat nuk zbatohen siç duhet - Rregullat janë të pakompletuara</u>**<br><br>1.Mos zbatimi i standardeve të kërkuara nga BE sa i përket vendosjes, përdorimit , ruajtjes dhe shpërndarjes në treg të PMB-ve;<br><br>2. Regjistrimi dhe përdorimi jo adekuat i PMB-ve organike;<br><br>3.Mos menaxhimi i integruar i dëmtuesve, ka si pasojë rritjen e nivelit të mbetjeve në bimë dhe produkte bimore;<br><br>4.Mbetjet e ambalazhit të PMB-ve shkaktojnë ndotjen e ujërave, tokës dhe ambientit;<br><br>5.Rrit potencialin e mbetjeve të PMB-ve në bimë dhe produkte bimore;<br><br>6. Mbetjet ePMB-ve ndikojnë në shëndetin e njeriut, bimëve, kafshëve, shpezëve dhe në mjedis;<br><br>7. Mos rregullimi i kritereve lidhur me masat ndaj personave fizik apo juridik të cilët veprojnë në kundërshtim me Ligjin për PMB-të. |

| | |
|---|---|
| | |
| **Problemi kryesor** | Avansimi i infrastrukturës ligjore për produktet për mbrojtjen e bimëve krahas rregulloreve dhe direktivave të reja të BE-së. |
| Shkaqet | <u>**Rregullat nuk zbatohen siç duhet:**</u><br><br>1. Korniza aktuale ligjore e pa harmonizuar;<br><br>2. Mos regjistrimi i PMB-ve organike;<br><br>3. Mungesë e menaxhimit të integruar të dëmtuesve;<br><br>4. Mungesa e menaxhimi të ambalazhit të zbrazët të PMB-ve;<br><br>5. Përdorimi jo profesional i PMB-ve;<br><br>6. Mungesa e përcaktimit të niveleve maksimale të PMB-ve në bimë dhe produkte bimore;<br><br>7. Mos zbatimi i sanksioneve nga gjykatat.<br><br><u>**Rregullat janë të pakompletuara**</u><br><br>Ligjit Nr. 03/L-042 Për produktet e mbrojtjes së bimëve dhe nën-aktet përkatëse nuk janë të përafruar me Rregulloren (EU) Nr.1107/2009, prandaj korniza aktuale ligjore e Kosovës për PMB-të është e pa kompletuar siç parashihet në rregulloret e BE-së, ndërsa kohë pas kohe është plotësuar me udhëzime adminstartaive por të cilat nuk përmbushin nevojat dinamike aktuale të sektorit te PMB-ve.<br><br><u>**Mangësitë në kornizën aktuale Ligjore të PMB-ve**</u><br><br>• Përcaktimin e niveleve maksimale të mbetjeve në ushqimin me origjinë bimore dhe shtazore; |

| | | |
|---|---|---|
| | • Rregullimin e sistemit të trajnimit për përdorimin e sigurt të produkteve të mbrojtjes së bimëve për përdoruesit, tregtuesit, distributorët dhe deponuesit profesional;<br>• Krijimi i një sistemi për testimin dhe inspektimin e rregullt të paisjeve për aplikim të produkteve për mbrojtjen e bimëve;<br>• Të rregullohet mbajtja e shënimeve dhe të dhënave për përdoruesit profesional të produkteve të PMB-ve;<br>• Përdorimin e qëndrueshëm të PMB-ve në prodhimtarinë bujqësore, së bashku me minimizimin e rrezikut nga përdorimi i tyre;<br>• Menaxhimi i intergruar i dëmtuesve (MID), nëpërmjet përdorimit të drejt të PMB-ve;<br>• Ndalimi i ndotjes së mjedisit ujor (sipërfaqësor dhe nëntokësor) nga PMB-të nëpërmjet nxitjes së aplikimit të masave të duhura nga prodhuesit bujqësorë dhe nëpërmjet monitorimit zyrtar të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore për PMB-të;<br>• Eliminimi i ndotjes së ujërave të pijshme dhe sipërfaqësore nga PMB-të duke krijuar zona sigurie;<br>• Ndalimi i përdorimit të PMB-ve, afër zonave jobujqësore si: parqet publike, zonat e argëtimit, shkollat, kopshtet, shtëpitë e pushimit, spitalet dhe objektet e tjera të kujdesit shëndetësor;<br>• PMB-të deponohen dhe trajtohen në mënyrë të përshtatshme nga të gjitha subjektet që i mbajnë në ambientet e tyre, në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i kontaminimit të operatorëve dhe kalimtarëve si dhe potenciali për dëmtim të mjedisit. | ***SHKAQE TE PROBLEMIT***<br>**Zbatimi joadekuat i legjislacionit për PMB-të** |

**1. Korniza aktuale ligjore e pa harmonizuar**

Ligjit Nr. 03/L-042 Për produktet e mbrojtjes së bimëve dhe aktet nënligjore nuk janë të përafruar me Rregulloren (EU) Nr.1107/2009, prandaj korniza aktuale ligjore e Kosovës për PMB-të është e pa kompletuar siç përcaktohet në rregulloret e BE-së.

Rregullorja (BE) Nr.1107/2009, i cili rregullon vendosjen në treg të PMB-ve, përdorimin, ruajtjen dhe shpërndarjen me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe ambientit.

Rëndësia e përafrimit gradual të legjislacionit me Acqui-në e BE-së është përcaktuar me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës, e hyrë në fuqi më 1 prill 2016. MSA-ja përfaqëson marrëdhënien e parë kontraktuale gjithëpërfshirëse ndërmjet Kosovës dhe BE-së dhe është një moment historik i rëndësishëm në procesin e integrimit evropian të Kosovës.

Krahas obligimeve nga MSA-ja, Kosova duhet të përmbushë edhe kërkesat që dalin nga Raportet Vjetore të KE-së për Kosovën. Dy raportet e fundit, për vitin 2020 dhe 2021, kanë theksuar vazhdimisht fushën e Mbrojtjes se bimeve, si një nga fushat kyçe për përmirësime. Prandaj, miratimi i kornizës së re ligjore për PMB-të konsiderohet si prioritet për Kosovën

**2. Mos regjistrimi i PMB-ve organike**

Mungesa e bazës ligjore ka shkaktuar mos regjistrimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve organike, si rrjedhojë e kësaj edhe kufizimin e numrit të subjekteve të cilat mirren me prodhi mtari organike.

**3. Mungesë e menaxhimit të integruar të dëmtuesve**

Rregullimi i baza ligjore per menaxhimin e intergruar te dëmtuesve krijon mundësin ne ndërmarrjen e veprimeve per te zvogëluar varësin e fermerve ne përdorim e produkteve per mbrojtjen e bimëve ne bime. Prodhimtaria e Integruar (PI) është një sistem bujqësore që ka për qëllim prodhimin e ushqimit cilësor dhe produkteve tjera duke përdorur burimet natyrore dhe mekanizmat tjerë të cilët zëvendësojnë inputet që shkaktojnë ndotje, me qëllim të krijimit të një bujqësie të qëndrueshme.Metodat biologjike, bujqësore dhe kimike janë të balancuar duke marrë në konsideratë mbrojtjen e ambientit, përfitimit dhe çështjeve apo kërkesat shoqërore.

**4. Mungesa e menaxhimi të ambalazhit të zbrazët të PMB-ve**

Mos krijimi i bazës ligjore për menaxhimin e ambalazhit të zbrazët të PMB-ve , shkakton ndotjen e ambientit, ujit të pijshëm, ujërave nëntoksore dhe sipërfaqsore.

Pas përdorimit të PMB-ve në sipërfaqe tokësore kemi sasira të mëdha të ambalazhit të zbrazët të cilat paraqesin burim të kontaminimit.

**5. Përdorimi jo profesional i PMB-ve**

Mungon baza ligjore për përdorues profesional të PMB-ve.

Përdorimi i PMB-ve e bëjnë personat jo adekuat të patrajnuar që paraqet një rrezik për mbetje të PMB-ve në bimë dhe tokë. Aplikimi i PMB-ve në bujqësi mund të çojë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore. Prandaj, ekziston nevoja për të krijuar zona sigurie për distancën e sigurisë nga mjediset ujorë, për t'i mbrojtur ata nga efektet anësore të përdorimit të PMB-ve. Zonat e sigurisë janë një mjet i rëndësishëm i menaxhimit të rrezikut për të mbrojtur cilësinë dhe sigurinë e ujit dhe mjedisit ujor, pasi brenda këtyre zonave, përdorimi i PMB-ve është i ndaluar.

**6. Mungesa e përcaktimit të niveleve maksimale të PMB-ve në bimë dhe produkte bimore**

Nuk është e rregulluar baza ligjore, munges e të dhënave nga IBK-ja rreth marrjes së mostrave për analizave të përcaktimin e niveleve të mbetjeve në bimë dhe produkte bimore e që nuk kemi të dhëna për sigurin ushqimore, pasi që tejkalimi i këtyre niveleve të mbetjeve shkakton sëmundje kancerogjene në organizmin e njeriut.Për të minimizuar ndikimet negative të PMB-ve është e rëndësishme të perdoren ato me kujdes dhe ne përputhje me udhëzimet e pergjitheshme të përdorimit.

**7. Mos zbatimi i sanksioneve nga gjykatat.**

Regjistrimi i personave fizikë dhe juridikë që angazhohen zyrtarisht në tregtinë e PMB-ve dhe vënia para drejtësisë e atyre që merren me aktivitete të paligjshme, do të ulë vëllimin e PMB-ve jo cilësore dhe të dyshimta në treg. Për këtë arsye, kontrolle më të rrepta mbi tregun e PMB-ve duhet të zbatohen nga Agjensioni i Ushqimit dhe Veterinës në bashkëpunim me Institutin Bujqësor të Kosovës të cilat funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Efektet:

**1. Mos zbatimi i standardeve të kërkuara nga BE sa i përket vendosjes, përdorimit , ruajtjes dhe shpërndarjes në treg të PMB-ve.**

Me përafrimin e legjislacionit nacional me atë të BE-së do të sigurohen nivele të larta në mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve dhe mjedisit dhe përmirësimin e funksionimit të tregut të brendshëm, niveleve maksimale të mbetjeve në ushqimin me origjinë bimore dhe shtazore si dhe Rregullimin e sistemit të trajnimit për përdorimin e sigurt të produkteve të mbrojtjes së bimëve për përdoruesit profesionistë, shpërndarësit dhe këshilltarët.

**2. Regjistrimi dhe përdorimi adekuat i PMB-ve organike.**

Do të rregullohet monitorimin dhe kontrollimi i PMB-ve, sidomos në parandalimin e futjes ilegale të PMB-ve. Përgjegjësitë themelore të Institucioneve dhe akterëve kryesorë për PMB-të do te përcaktohen qartë dhe do të pasqyrojnë në tërësi rolin për tregtimin e PMB-ve dhe regjistrimin e produkteve organike sipas standardeve.

**3. Mos menaxhimi i integruar i dëmtuesve, ka si pasojë rritjen e nivelit të mbetjeve në bimë dhe produkte bimore.**

Do të fillojmë me aplikimin e praktikave të mira bujqësore - prodhimtarinë e integruar dhe ofrimin e këshillave fermerëve për zvogëlimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve në bimë dhe produkte bimore që të ndikoj në përmirsimin e shëndetit të bimëve dhe kontrollin e dëmtuesve. Aplikimi i PMB-ve do të jetë në kohë dhe të kombinohet me praktikat e vendeve tjera të menaxhimit të dëmtuesve. Dëmtuesit të identifikohen me saktësi dhe aplikimet e PMB-ve të bëhen vetëm kur është e nevojshme, duke përdorur sasinë më të vogël të nevojshme për kontrollin adekuat të dëmtuesve.

**4. Mbetjet e ambalazhit të PMB-ve shkaktojnë ndotjen e ujërave, tokës dhe ambientit.**

Krijimi i infrastrukturës ligjore, do të krijon nje bazë për trajtim të ambalazhit, duke përfshirë regjistrimin e subjekteve për grumbullim dhe riciklim të ambalazhit.

Do të krijojm një skemë për menaxhimin e mbeturinave nga ambalazhi i PMB-ve ku do të minimizohet rreziku i përdorimeve të serishëm dhe do të sigurohet mënjanimi i sigurt i paketimeve boshe. Në këtë skemë do të përfshihen fermerët, industrit, akterët e tjerë dhe autoritetet kompetente, që të jetë në mbrojtje të mjedisit dhe njerzve.

**5. Rrit potencialin e mbetjeve të PMB-ve në bimë dhe produkte bimore.**

Do te behet rregullimi i përdorimit te PMB-ve me persona te trajnuar qe mos te shkaktojnë sasi te medhe te mbetjeve te PMB-ve ne bime dhe toke. Do të krijohet një sistem trajnimesh të detyrueshme për PMB-të për stafin e kompanive të përfshira në tregtinë e tyre, për konsulentët për përdorimin e PMB-ve dhe për përdoruesit profesionistë të PMB-ve i cili do të pajiset me certifikatave të trajnimit dhe certifikatave speciale të trajnimit. Niveli i rritur i njohurive të stafit tregtar dhe përdoruesve profesionistë të PMB-ve, do të kontribuojë në reduktimin e rreziqeve të lidhura me PMB-të.

**6. Mbetjet e PMB-ve ndikojnë në shëndetin e njeriut, bimëve, kafshëve, shpezëve dhe në mjedis.**

Mungon infrastruktura ligjore, ku do të rregullohen përgjegjësit e inspektoreve fitosanitar duke filluar në marrjen e mostrave të produkteve bimore dhe shtazore për analiza dhe testim, detyurimet e laboratorëve për analiza të mostrave dhe përcaktimin e niveleve të mbetjeve maximale në bimë dhe produkte bimore dhe shtazore.
Me funksionalizimin e infrastrukturës do të ketë një bazë të mirë për cilësinë e produkteve me origjin bimore dhe shtazore, e cila është e lidhur në zingjirin e sigurisë ushqimore.

**7. Mos rregullimi i kritereve lidhur me masat ndaj personave fizik apo juridik të cilët veprojnë në kundërshtim me Ligjin për PMB-të.**

Në mungesë të masave sanksionuese ndaj personave fizik apo juridik të cilët veprojnë në kundërshim me ligjin për PMB-të, krijohen mundësi që në tregun tonë të ketë PMB të importuara të cilat poashtu mund të mos jenë në Listën e PMB-ve të Republikës së Kosovës. Andaj për t'ju shmangur këtyre situatave, duhet paraparë që masat ligjore të jenë të rregulluara

me Ligj, dhe në rast mos zbatimit të tyre nga personat fizik apo juridik, atëherë të njëjtat duhet të ndëshkohen sipas kritereve të përcaktuara në Ligjin për PMB-të.

**Palët me interes – ( Përditësohet pas definimit të saktë të shkaqeve dhe ekefteve )**

*Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit*

| **Emri i palës së interesuar** | **Shkaku/qet me të cilat është e lidhur pala** | **Efekti/et me të cilat është e lidhur pala** | **Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)** |
|---|---|---|---|
| MBPZHR | 1.Korniza aktuale ligjore e pa harmonizuar;<br><br>2.Mos regjistrimi i PMB-ve organike;<br><br>3. Mungesë e menaxhimit të integruar të dëmtuesve. | 1.Mos zbatimi i standardeve të kërkuara nga BE sa i përket vendosjes, përdorimit , ruajtjes dhe shpërndarjes në treg të PMB-ve;<br>2. Regjistrimi dhe përdorimi jo adekuat i PMB-ve organike;<br><br>3.Mos menaxhimi i integruar i dëmtuesve, ka si pasojë rritjen e nivelit të mbetjeve në bimë dhe produkte bimore. | MBPZhR- është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe legjislacionit lidhur me regjistrimin, importimin,tregtimin menyren e vendosjes, përdorimit , dponimin dhe shpërndarjes në treg të PMB-ve. |
| IBK | 5.Përdorimi jo profesional i PMB-ve;<br><br>6.Mungesa e përcaktimit të niveleve maksimale të PMB-ve në bimë dhe produkte bimore. | 5.Rrit potencialin e mbetjeve të PMB-ve në bimë dhe produkte bimore;<br><br>6. Mbetjet ePMB-ve ndikojnë në shëndetin e njeriut, bimëve, kafshëve, shpezëve dhe në mjedis. | IBK- është përgjegjës për realizimin e analizave dhe testimeve per niveleve maksimal te PMB-ve ne bime dhe produkte ushqimore ne bime ne bashkëpunim me AUV dhe MBPZHR; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës (AUV) | Mungesa e menaxhimi të ambalazhit të zbrazët të PMB-ve; | 4.Mbetjet e ambalazhit të PMB-ve shkaktojnë ndotjen e ujërave, tokës dhe ambientit; | AUV- është përgjegjës për zbatimin e politikave dhe legjislacionit të hartuar nga MBPZHR, në funksion të kontrollit dhe monitorimit të përgjithshëm të PMB-ve në nivel vendi. |

Kapitulli 2: Objektivat

*Objektivat relevante të Qeverisë*

Siç është paraparë nga MSA-ja, Kosova ka zhvilluar Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKZMSA) si një dokument kryesor strategjik kombëtar për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të të gjitha reformave të nevojshme për zbatimin e MSA-së dhe fazat e ardhshme të anëtarësimit në BE. PKZMSA për vitet 2021-2025 përcakton një kornizë gjithëpërfshirëse afatmesme të të gjitha reformave të kërkuara për të përmbushur detyrimet që dalin nga MSA, përkatësisht masat dhe prioritetet e kërkuara për përafrimin gradual të legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së, duke e transpozuar këtë të fundit në legjislacionin kombëtar, dhe zbatimin e legjislacionit të përafërt. BE merr gjithashtu parasysh rekomandimet e dhëna çdo vit nga raportet e KE-së dhe për këtë arsye njeh rëndësinë e qasjes së integruar për sigurinë ushqimore që synon të sigurojë një nivel të lartë të sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve, mirëqenies së kafshëve dhe shëndetit të bimëve.

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 është dokumenti bazë përmes të cilit Qeveria ua komunikon vizionin qytetarëve të Republikës së Kosovës në lidhje me qeverisjen e saj. Ai pasqyron qasjen dhe parimet që duhen ndjekur gjatë gjithë qeverisjes, si dhe prioritetet dhe nismat bazë që do të ndërmerren në të gjitha fushat për përmirësimin e situatës në vend. Ky program pasqyron orientimet e përgjithshme në lidhje me agjendën e integrimit evropian dhe

politikën e jashtme. Ai transmeton frymën demokratike dhe pluraliste të vendit, e cila siguron përfundimin e procesit të shtet ndërtimit dhe integrimin e plotë të Republikës së Kosovës në institucionet rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare.

Sipas Programit Qeveritar 2021-2025, objektivi është avancimi i politikave të sigurisë ushqimore dhe harmonizimi i tyre me standardet e BE-së, të cilat synojnë të sigurojnë një nivel të lartë të sigurisë së ushqimit, shëndetit të kafshëve dhe shëndetit të bimëve. Në këtë drejtim, prioritet do t'i jepet hartimit të kornizës ligjore për përdorimin dhe tregtimin e PMB-ve.

Qëllimet e politikave dhe objektivat strategjikë janë tashmë të parapërcaktuar në dokumentet strategjike qeveritare, ndërsa objektivat specifike janë rezultat i përcaktimit të detajuar të problemit siç përshkruhet në Kapitullin 2 të këtij dokumenti, pasi ato përcaktojnë objektivat konkrete që duhen arritur.

Klasifikimi SMART i objektivit të përgjithshëm përshkruhet në tabelën e mëposhtme:

| | Përshkrimi |
|---|---|
| **Specifika** | Objektivi i përgjithshëm është avancimi i politikave të sigurisë së ushqimit dhe harmonizimi i tyre me standardet e BE-së me qëllim të sigurimit të një niveli të lartë të sigurisë së ushqimit, shëndetit të njerzëve, kafshëve dhe mbrojtjes se mjedisit duke adresuar përafrimin saktësisht konkret të legjislacionit kombëtar të Kosovës me Rregulloren (BE) Nr. Nr.1107/2009. |
| **Të matshme** | Miratimi i Ligjit të ri nga Kuvendi dhe publikimi i tij në Gazetën Zyrtare të RKS-së, bazuar në Rregulloren e BE - së Nr. Nr.1107/2009. |
| **E arritshme** | Objektivi i përgjithshëm pritet të arrihet përmes kapaciteteve juridike dhe politike të institucioneve relevante qeveritare dhe Kuvendit të Kosovës. |
| **Relevante** | Rëndësia e PMB-ve shpjegohet në kapitujt 1 dhe 2 të këtij dokumenti. Objektivi i përgjithshëm mbështet sektorin e mbrojtjes së bimëve të Kosovës në kërkimin e tij drejt konkurrencës dhe tregut të sigurt të PMB-ve. |
| **I kufizuar në kohë** | Afati kohor përcaktohet nga procedurat, koha e nevojshme për finalizimin e koncept dokumentit si dhe koha e nevojshme për hartimin, diskutimin, finalizimin dhe miratimin e ligjit të ri bazuar në Rregulloren (BE) Nr. Nr.1107/2009 nga institucionet përkatëse sipas rregullave në fuqi në RKS. |

*Kapitulli 2: Objektivat*

*Objektivat relevante të Qeverisë*

*Qëllimi i përgjithshëm Objektivi strategjik dhe Objektivat specifike:*

| **Qëllimi i përgjithshëm i politikës – Avansimi i politikave të PMB-ve në prodhimtarinë bujqësore për të siguruar prosperitet ekonomik të vendit** | |
|---|---|
| **Objektivi strategjik:**<br>Avancimi i politikave për siguri ushqimore dhe përafrimi i tyre me standardet e BE-së, të cilat synojnë të sigurojnë një nivel të lartë të ushqimit për njeriun dhe shëndetin e bimëve nga përdorimi i qëndrueshëm i produkteve për mbrojtjen e bimëve.<br><br>**Objektivat specifike:**<br>- Regjistrimi, importimi, ruajtja dhe vendosja në treg e PMB-ve të bëhet sipas legjislacionit të BE-së;<br>- Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit për PMB-të dhe inspektimit pas regjistrimit;<br>- Mbrojtja e fermerëve vendor nga importimi dhe tregtimi i PMB-ve jo cilësore dhe ngritja e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë e PMB-ve;<br>- Krijimi i sistemit për trajnime të detyrueshme për përdoruesit profesional të PMB-ve;<br>- Pajisjet për përdorim profesional për aplikimin e PMB-ve, të regjistrohen dhe të inspektohen në intervale të rregullta, në mënyrë që të arrihet niveli i lartë i mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe mjedisit.- Ngritja e kapaciteteve për Institucionet relevante, gjyqtarët dhe | - **Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025**<br><br>**2.10. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural;**<br><br>**2.10.1 Reformat gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për shërbime më efikase;**<br><br>**2.10.2. Rritja e konkurrencës në sektorin agro-ushqimor;**<br><br>**2.10.5 Siguria e ushqimit .**<br><br>- **Plani Kombëtar për Zhvillim**<br><br>**Qëllimi zhvillimor dhe qëllimi strategjik:**<br>**- 1.9 Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme në mes të fermerëve, përpunuesve dhe shitësve me pakicë;**<br>- **Masa Strategjike: Përmbushja e kërkesave për ushqimin të sigurtë dhe të shëndetshëm;**<br><br>**Aktivititeti– Hartimi i Koncept Dokumentit për Produktet për Mbrojtjen e Bimëve**<br><br>**Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 Shtylla e I – Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik:**<br>**Qëllimi Zhvillimor: Ekonomi digjitale,** |

| | |
|---|---|
| përmbaruesit. | **qarkore dhe konkurruese:**<br>**Qëllimi Strategjik: 1.9 Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme mes fermerëve, përpunuesve e shitësve me pakicë.** |
| **Objektivat specifike Opsioni 2:**<br>• Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit;<br>• Mbrojtja e shëndetit të njerzëve, kafshëve dhe mjedisit;<br>• Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e përdorimit të PMB-ve;<br>• Rritja e buxhetit për trajnimin e inspektorëve fitosanitarë për PMB-të;<br>• Koordinim më i mirë ndërinstitucional në mes MBPZhR, IBK-së, AUV-it, Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë (FBV), Doganës, Kompanive prodhuese të PMB-ve, si dhe Shoqatave Importuese-tregtuese të PMB-ve me qëllim harmonizimin dha avansimin e politikave për sektorin e PMB-ve;<br>• Vetëdijësimin e fermerëve përmes organizimit të kampanjes dhe sensibilizimit të institucioneve përgjegjëse, mbi rolin e sektorit të PMB-ve. | Të hartuara për nevojat e këtij KD |
| **Objektivat specifike Opsioni 3:**<br><br>- Regjistrimi, importimi, ruajtja dhe vendosja në treg e PMB-ve të bëhet sipas | Të hartuara për nevojat e këtij KD |

| | |
|---|---|
| Standardeve të BE-së;<br><br>- Përcaktimi i institucionit përgjegjës për analizë dhe vlerësim të PMB-ve;<br><br>- Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit dhe inspektimit të PMB-ve pas regjistrimit;<br><br>- Mbrojtja e fermerëve vendor nga importimi dhe tregtimi i PMB-ve jo cilësore dhe ngritja e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë e produkteve cilësore;<br><br>- Të krijohet një sistem për trajnime të detyrueshme për përdorim profesional të PMB-ve;<br><br>- Paisjet për përdorim profesional për aplikimin e PMB-ve, të regjistrohen dhe të inspektohen në intervale të rregullta, në mënyrë që të arrihet niveli i lartë i mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe mjedisit;<br><br>- Ngritja e kapaciteteve për Institucionet relevante, gjyqtarët dhe përmbaruesit. | |

### *Praktikat e vendeve të rajonit lidhur me PMB-të*

PMB-të për mbrojtjen e bimëve janë zinxhirë shumë i rëndësishëm në ruajtjen e shëndetit të njerzëve, kafshëve dhe mbrojtjen e mjedisit. Shtetet e regjionit dhe ata të BE-së bashkëpunojnë intenzivisht në të gjitha fazat e proceseve integruese duke përafruar legjislacionin dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve përmes bashkëpunimit në nivel bilateral mes shteteve të regjionit, BE-së dhe institucioneve relevante profesionale për PMB-të.

***<u>Shembulli i Republikes së Kroacisë</u>***

Bazuar ne Ligjin Nr.46/2022(15 Prill 2022) PËR PËRDORIM TË QËNDRUESHËM TË PMB-ve i cili rregullon përdorimit të qëndrueshëm të PMB-ve, zvogëlimin e rreziqeve dhe efekteve negative nga përdorimi i pesticideve në një mënyrë që siguron një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe kafshëve, si dhe mbrojtje dhe ruajtje të mjedisit të biodiversitetit, futja e zbatimit të detyrueshëm të parimeve bazë të mbrojtjes së integruar të bimëve për kontrollin e

organizmave të dëmshëm të bimëve dhe qasjet dhe teknikat alternative, si masat jo kimikë të mbrojtjes së bimëve për të arritur një bujqësi të qëndrueshme dhe konkurruese. Ky ligj zbatohet për PMB-te që janë produkte për mbrojtjen e bimëve, siç përcaktohet në nenin 4, paragrafi 1, pika 16, nënpika a)te këtij ligji.

KAPITULLI III, Neni 7 paragrafët 1 deri 9 si dhe Nenet 8 dhe 9 paraqesin Planin Kombëtar të Veprimit për arritjen e përdorimit të qëndrueshëm të PMB-ve.

KAPITULLI IV deri te KAPITULLI I V janë te rregulluara sistemi i trajnimit për përdoruesit profesionistë të PMB-ve, shpërndarësit dhe këshilltarët, përdorimin e kredencialeve elektronike të nivelit të duhur për akses në Sistemin Informativ Fito sanitar, shpërndarjen dhe sistemi i shitjes së PMB-ve, trajtimi i PMB-ve, ruajtja dhe trajtimi i paketimit të PMB-ve dhe mbetjeve në ambalazh, mbajtja e koleksioneve të dhënave dhe mbajtja e shënimeve.

KAPITULLI VI e deri te VII janë të rregulluara përdorimi dhe inspektimi i rregullt i pajisjeve për aplikimin PMB-ve, informimi i publikut dhe ngritja e nivelit të ndërgjegjësimit për PMB-ve, masat për uljen e rrezikut të përdorimit të PMB-ve dhe parimet bazë të mbrojtjes së integruar të bimëve, procedurat e veçanta dhe përdorimi i PMB-ve.

KAPITULLI VII e ka të rregulluar aplikimi ajror, njoftimi publik, masat e veçanta të mbrojtjes së mjedisit, reduktimi i përdorimit të PMB-ve dhe reduktimi i rrezikut në zona të caktuara, mbrojtja e bletëve gjatë aplikimit të PMB-ve, aplikimi i PMB-ve në zonat publike dhe të gjelbra, treguesit e rrezikut.

KAPITULLI VIII Neni 84, paragrafët nga 1 deri ne 10 dhe Neni 85 me paragrafët 1 deri 4, kanë të rregulluara ofrimin e shërbimeve të trajtimit, raportimi dhe shkëmbimi i informacionit, institucionet e autorizuara të ekspertëve dhe detyrat e institucioneve të autorizuara profesionale, Komisionit për PMB-ve, si dhe KAPITULLI IX TARIFAT DHE KOSTOT, tarifa dhe kundërvajtje dhe mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregulloreve të miratuara në bazë të këtij ligji. KAPITULLI X MBIKQYRJA ADMINISTRATIVE dhe PROFESIONALE DHE KAPITULLI XI DHE XII DISPOZITAT NDESHKIMORE.

***<u>Shembulli i Republikës së Shqipërisë</u>***

Në kuadër të shembullit të një vendi nga regjioni është marr Shqiperia, e cila përmes Ligjit Nr. 105/2016 PËR MBROJTJEN E BIMËVE (ndryshuar me ligjin nr. 15/2022, datë 3.2.2022) (i përditësuar), në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e

Këshillit të Ministrave. Ligjit Nr. 105/2016 PËR MBROJTJEN E BIMËVE është një ligj i përbashkët me Produktet për Mbrojtjen e Bimëve.

KREU V- PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMEVE. Në këtë Ligj janë identifikuar disa pika të cilat ne i kemi paraqitur në Koncept Dokument si mangësi ligjore, të cilat mund të përdoren si referenca për vendin tonë. Regjistrim i të gjitha PMB-ve që tregtohen ose përdoren janë të rregulluara në Nenin 19, pika 1 deri 5 dhe Neni 20 pikat 1 deri 7 dhe nënpikat **a** deri në **dh**. Lidhur me tregtimin e materjalit mbjelles të dezinfektuar në Nenin 21 pika 1 dhe 2 lejohet tregtimi i materjalit mbjellës të dezinfektuar me një PMB e cila është e regjistruar në Republikën e Shqipërisë ose në një vend të BE-së. Mënyra e transportit dhe ruajtjes së PMB-ve është e rregulluar në Nenin 22 pika 1 deri 4 si dhe nënpikat nga **a** deri ne **d**, poashtu Neni 23 nga pika 1 deri 7 rregullon përdorimin e qëndrueshëm të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve. Neni 24 pika 1 deri 4 dhe Neni 25 pika 1 deri 4 dhe nënpika e rregullojnë ambalazhin, asgjesimin e PMB-ve dhe ambalazhin e tyre.

Neni 26 pika 1 deri në 2 si dhe nënpikat paraqesin të dhënat statistikore për PMB-të dhe Neni 27 pikat 1 deri ne 3 përcakton gjurmueshmërin në nivele të prodhimit bimor në rrezik.

KREU VI – KUNDERVAJTJET ADMINISTRATIVE; NENI 29 procedurat e kundërvajtjeve, të drejtën e dhënies së masës administrative si e përcakton Neni 28 i këtij ligji e ka inspektori i organit të kontrollit.

Në Shqipëri janë në fuqi Ligjet dhe rregulloret e mëposhtme, në lidhje me cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, mbrojtjen e ujit dhe monitorimin e substancave të rrezikshme në ujë, Ligji nr. 111/2012, datë 15.12.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".

- VKM Nr. 246, datë 30.4.2014 "Për përcaktimin e standardeve të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore", VKM Nr. 267, datë 7.5.2014 "Për miratimin e listës së substancave prioritare në mjediset ujore". Në ligjin bazë, nr. 105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar, në nenet nr. 22, 23, 24 dhe 25, përcaktohen përkatësisht rregullat dhe kriteret e përgjithshme për transportin dhe ruajtjen e PMB-ve, përdorimin e qëndrueshëm të PMB-ve, paketimin e PMB-ve, asgjësimin e PMB-ve dhe të paketimeve të tyre.

***Shembulli i Republikës së Slovenisë***

Bazuar në Ligjin per Produkte Fitofarmaceotike Nr.83/12 dhe Gazeta Zyrtare Nr.35/23, 27 Mars 2023. Objektivat e këtij ligji janë që FFS të përdoren në një mënyrë që mundëson zhvillimin e një bujqësie të qëndrueshme dhe konkurruese dhe siguron një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit

të njerëzve dhe kafshëve dhe mbrojtjes së mjedisit, futjen e përdorimit të detyrueshëm të mbrojtjes së integruar të bimëve kundër organizmave të dëmshëm dhe promovimin e qasjeve dhe teknikave alternative në fushën e shtypjes së tyre.

Kapitulli II. VLERËSIMI I SUBSTANCAVE AKTIVE DHE REGJISTRIMI I FFS, Neni 5, paragrafi 1 deri 5 paraqet Regjistrimi dhe lejet e FFS, Neni 7 paragrafi 1 deri 9,testet e performancës Neni 8 paragrafi 1-3,tarifat.

Kapitulli III, Neni 9, paragrafi 1 deri në 5, paraqet Programin Kombëtar të Veprimit për FFS Kapitulli IV, Neni 10 , është e rregulluar tregti me shumicë dhe pakicë me FF, Neni 11 rregullon shitësit dhe konsulentit FFS, Neni 16, në përputhje me nenin 67 të Rregullores 1107/2009/EC, distributorët e përmendur në nenin 10 të këtij ligji duhet të mbajnë dhe ruajnë të dhëna për të paktën emrin tregtar dhe sasinë e FFS në qarkullim. Neni 17 përdorimi i duhur FFS, Neni 18, trajtimi i paketimit dhe mbetjeve FFS, ku shpërndarësit dhe përdoruesit e FFS duhet të trajtojnë paketimin dhe mbetjet e FFS në mënyrën e përcaktuar nga rregulloret që rregullojnë menaxhimin e mbetjeve, rregulloret që rregullojnë paketimin dhe mbetjet e paketimit dhe në rastin e FFS, rregulloret që rregullojnë menaxhimin e mbetjeve FFS që përmbajnë substanca të rrezikshme. Neni 19 rregullon të dhënat e përdorimit të FFS.

Kapitulli V, TRAJNIM nga Neni 22,23, 24,25, Neni 22 rregullohet trajnimi i përdoruesit profesionistë, shitësit e FFS dhe konsulentët FFS, si dhe personat e tjerë që dëshirojnë të marrin një certifikatë të përvetësimit të njohurive në fitomjekësi, 23 Administrata zgjedh, në bazë të tenderit publik, për një periudhë pesë vjeçare, ofruesit e trajnimit të përmendur në nenin 22 të këtij ligji të cilët janë persona juridikë ose fizikë dhe janë të regjistruar për të kryer, zhvillon veprimtari edukative dhe plotëson kushtet në lidhje me mjediset dhe pajisjet teknike, si dhe të ketë të paktën një pedagog në marrëdhënie pune ose kontraktuale për secilën nga fushat profesionale të fitomjekësisë, i cili është i njohur me përmbajtjen dhe programin e trajnimit në fushën e fitomjekësisë dhe plotëson, kushtet nga neni 24 i këtij ligji, Neni 25, Trajnimi për trajtimin e FFS nga paragrafi i parë i nenit 22 të këtij ligji përfshinë trajnimin bazë dhe atë të mëtutjeshëm. Neni 26, ofruesit të trajnimit i jepet certifikata nga Administrata.

Kapitulli VI. PAJISJET E APLIKIMIT FFS nga Neni 27, 28 deri te Neni 29, ky kapitull rregullon kontrollin dhe certifikimin e paisjeve. Neni 35 mbrojtja e integruar e bimëve kundër organizmave të dëmshëm.

Kapitulli IX. DETYRA PROFESIONALE, PUNË KËRKIMORE DHE LABORATORI nga Neni 38,39

Kapitulli X. MBLEDHJA E TË DHËNAVE, PËRTRITJA DHE PËRDORIMI I TË DHËNAVE, Neni 42, Kapitulli XI. KONTROLLI I INSPEKTIMIT, Inspektorët fitosanitar mbikëqyrin zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë të tij.

## Kapitulli 3: Opsionet

### 3.1: Opsioni asnjë ndryshim

Opsioni i parë është që të vazhdohet me zbatimin e politikës dhe kornizës ligjore aktuale për PMB-të, por zbatimi i këtij ligji në praktikë është sfidues për MBPZhR-në. Me vazhdimin e opsionit pa ndryshime do të vazhdojnë problemet e cekura më lart për regjistrimin, tregtimin dhe përdorimin e PMB-ve. Gjithashtu edhe definimi jo i qartë i kompetencave në mes nivelit qendror dhe atij lokal, mungesa e mbikëqyrjes adekuate të zbatimit të Ligjit.

### 3.2. Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit

Ky opsion parasheh plotësim-ndryshimin e Ligjit për PMB-të, i cili do të eliminonte shkaqet dhe efektet e cekura te definimi i problemit.

Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje - Divizioni i Mbrojtjes së bimëve është përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të Ligjit për PMB-ve përmes inspektorëve fitosanitar. Aktualisht numri i inspektorëve është i kufizuar për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të PMB-ve.

Për përmirësimin e menaxhimit të qëndrueshëm të PMB-ve Opsioni 2 parasheh të ndërmerren këto masa:

- Rritjen e buxhetit për rritjen e numrit të inspektorëve fitosanitar në nivelin qendror dhe komunal;
- Koordinim me të mirë ndërinstitucional në mes të nivelit qendror dhe lokal (MBPZHR, MMPHI, MAPL, komunat), për harmonizimin e politikave në menaxhimin e qëndrueshëm të PMB-ve;
- Trajnimet dhe ngritja e kapaciteteve të stafit;
- Vetëdijësimin e popullatës përmes organizimit të kampanjës dhe sensibilizimit të institucioneve përgjegjëse.

### 3.3. Opsioni i tretë me ndryshime

Projektligji për Produktet për mbrotjen e bimëve adreson çështjet që janë të parregulluara apo kanë zbrazëtira juridike. Duke parë gjendjen e tanishme në zbatimin e kornizës ligjore për PMB-të është paraparë hartimi i Ligjit të ri për PMB-të për shkak të direktivave të shfuqizuara dhe fuqizimit të rregullores së re.

Sipas këtij opsioni, Projektligji do të përcaktonte parimet dhe objektivat për politikën e PMB-ve që kërkohen për të arritur rezultatet e dëshiruara dhe qasje gjithëpërfshirëse. Të gjitha standardet lidhur me PMB-të, do të harmonizohen me standardet ndërkombëtare të BE-së, ashtu edhe Organizaten Europiane për Mbrojtjen e Bimëve (OEMB).

Projektligji i ri për produktet për mbrojtjen e bimëve do të krijoi rregulla të reja për harmonizimin dhe standardizimin e lejeve, licencave standarde për bujqësinë dhe mjedisin .

Transpozimi i rregullave dhe direktivave të Acquis të BE-së për produktet për mbrojtjen e bimëve ka bërë të pa zbatueshme aktet ligjore primare dhe sekondar në fuqi, duke shtuar se këto rregulla duhet të shfuqizohen.

Përmes kësaj politike synohet efikasiteti dhe efektiviteti më i madh i krijimit të politikave bujqësore për produktet për mbroijtjen e bimëve.

Ndër objektivat kryesore janë harmonizimi i legjislacionit me Acquis e BE-së, krijimi i kornizës ligjore për zbatimin e afateve të përcaktuara me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe sanksioneve me Ligjin për kundërvajtje si dhe përfaqësimi më efikas i interesave të fermerëve dhe shoqatave të fermerëve të biznesit për regjistrimin e ri dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Të gjitha këto ndryshime planifikohen të arrihen duke filluar nga viti 2024 ndërsa përgjegjës kryesor do të jetë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe të gjitha organet tjera relevante në nivel qendror dhe komunal për vendosjen e rregullave të mbrojtjes së produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe sistemin e tyre rregullues të regjistrimit dhe autorizimit të tyre.

Projektligji i ri për PMB-të përfshinë elementet themelore si në vijim:

- Përdorimin e qëndrueshëm të PMB-ve dhe rregullat minimale për përdorimin e PMB-ve në Komunitet, në mënyrë që të ulë rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin;
- Promovon përdorimin e menaxhimit të integruar të dëmtuesve;
- Mbledhjen e statistikave për përdorimin e PMB-ve, përdoruesit janë të detyruar t'i vënë të gjitha të dhënat për përdorimin e PMB-ve në dispozicion të autoriteteve kompetente;

- Mbetjet Maksimale të Lejuara (MML-ve) për të gjitha produktet ushqimore të trajtuara me PMB. MML-të pasqyrojnë sasinë më të lartë të PMB-ve që pritet të gjendet në një bimë të trajtuar, në përputhje me praktikat e mira bujqësore;
- Monitorimin dhe kontrollimin e PMB-ve;
- Regjistrimin e produkteve organike;
- Sistemin e trajnimit për përdorimin e sigurt të PMB-ve për përdoruesit profesionistë, shpërndarësit dhe këshilltarët;
- Sistemin për testimin dhe inspektimin e rregullt të pajisjeve për aplikimin e pajisjeve për mbrojtjen e bimëve;
- Sistemin e kontrollit zyrtar në lidhje me përdorimin e PMB-ve;
- Të përcaktohen dispozitat për kundërvajtje në të gjitha fushat e listuar në Rregulloren e BE-së 2016/429.

Ky opsion do të krijonte kornizën adekuate ligjore për PMB-të të harmonizuar me Acquis të BE-së, parakushtet për zbatimin teknik dhe efektiv të masave për PMB-të në përputhje me objektivat e kornizës së re legjislative të BE-së dhe një bazë për përgatitjen në kohë të programeve në fushën e mbrojtjes bimeve. Do të ketë gjithashtu rëndësi në rritje për të lehtësuar tregtinë e sigurt ndërkombëtare të PMB-ve duke shmangur pengesat e panevojshme për tregtinë. Megjithëse, korniza e përgjithshme legjislative mund të mos përmbajë dispozita të hollësishme dhe specifike legjislative. Këto rregulla do të përcaktohen në një fazë të mëvonshme me anë të legjislacionit dytësor.

**Praktikat e vendeve të rajonit, të cilat mund të gjejnë zbatim në Republikën e Kosovës dhe të cilat do të mirren parasysh gjatë hartimit të Projektligjit janë:**

***Praktikat e Republikës së Shqipërisë:*** Bazuar në Ligjin Nr. 105/2016 PËR MBROJTJEN E BIMËVE (ndryshuar me ligjin Nr. 15/2022, datë 3.2.2022), (i përditësuar), Ligji nr. 105/2016, KREU V- PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 105/2016, si dhe me plotësimin dhe ndryshimin me Ligjin Nr. 15/2022, i ka të rregulluara disa pika të cilave mund t'i referohemi si janë: Nenin 21 pika 1 dhe 2 lejohet tregtimi i materjalit mbjellës të dezinfektuar me një PMB e cila është e regjistruar në Republikën e Shqipërisë ose në një vend të BE-së. Mënyra e transportit dhe ruajtjes së PMB-ve është e rregulluar në Nenin 22 pika 1 deri 4, si dhe nënpikat nga **a** deri ne **d.** Neni 25 pika 1 deri 4 dhe nënpikat që e rregullojnë ambalazhin, asgjësimin e PMB-ve dhe ambalazhin e tyre.

Neni 26 pika 1 deri ne 2 si dhe nënpikat paraqesin të dhënat statistikore për PMB-të dhe Neni 27 pikat 1 deri ne 3 përcakton gjurmueshmërinë në nivele të prodhimit bimor në rrezik.

Sipas VKM 317 datë 15.5.2019, pajisjet e aplikimit PMB duhet të funksionojnë në mënyrë të besueshme dhe të përdoren siç duhet për qëllimin e synuar në mënyrë që PMB-të të mund të përdoren me saktësi. Pajisja duhet të jetë në gjendje të tillë që të mund të mbushet dhe zbrazet në mënyrë të sigurt, lehtësisht dhe plotësisht dhe të parandalojë rrjedhjen e PMB-ve. Ajo duhet të lejojë pastrim të lehtë dhe të plotë. Gjithashtu duhet të sigurojë operime të sigurta dhe të kontrollohet dhe ndalohet menjëherë nga ana e operatorit. Kur është e nevojshme, rregullimet duhet të jenë të thjeshta, dhe të sakta. Regjistrimi i PMB-ve bëhet nëpërmjet sistemit *e-Albania,* ku kërkuesi (aplikanti) plotëson drejtpërdrejt kërkesën, duke ngarkuar dokumentacionin sipas kërkesave ligjore. Dokumentet e regjistrimit dërgohen në formë elektronike pasi të jetë kryer pagesa e regjistrimit dhe të jetë dorëzuar mandati i pagesës në formë elektronike..

***Praktikat e Republikës së Kroacisë:*** Ligjit Nr.46/2022(15 Prill 2022), ka për qëllim përdorimin e qëndrueshëm të PMB-ve, zvogëlimin e rreziqeve dhe efekteve negative nga përdorimi i PMB-ve në mënyrë që te siguron një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe kafshëve, si dhe mbrojtje dhe ruajtje të mjedisit të biodiversitetit, futjen e zbatimit të detyrueshëm të parimeve bazë të mbrojtjes së integruar të bimëve për kontrollin e organizmave të dëmshëm të bimëve dhe qasjet dhe teknikat alternative, si masat jokimike të mbrojtjes së bimëve për të arritur një bujqësi të qëndrueshme dhe konkurruese. Në këtë Ligj nga KAPITULLI IV deri te KAPITULLI I V janë të rregulluara sistemi i trajnimit për përdoruesit profesionistë të PMB-ve, shpërndarësit dhe këshilltarët, përdorimin e kredencialeve elektronike të nivelit të duhur për akses në Sistemin Informativ Fitosanitar, shpërndarjen dhe sistemi i shitjes së PMB-ve, trajtimi i PMB-ve, ruajtja dhe trajtimi i paketimit të PMB-ve dhe mbetjeve në ambalazh, mbajtja e koleksioneve të dhënave dhe mbajtja e shënimeve. KAPITULLI VI e deri te VII janë të rregulluara përdorimi dhe inspektimi i rregullt i pajisjeve për aplikimin PMB-ve, informimi i publikut dhe ngritja e nivelit të ndërgjegjësimit për PMB-ve, masat për uljen e rrezikut të përdorimit të PMB-ve dhe parimet bazë të mbrojtjes së integruar të bimëve, procedurat e veçanta dhe përdorimi i PMB-ve.

KAPITULLI IX TARIFAT DHE KOSTOT, tarifa, kundërvajtja dhe mbikëqyrja mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregulloreve të miratuara në bazë të këtij ligji. KAPITULLI X MBIKQYRJA

ADMINISTRATIVE DHE PROFESIONALE DHE KAPITULLI XI DHE XII DISPOZITAT NDESHKIMORE.

***Praktikat e Republikës së Slovenisë***

Ligjin për Produkte Fitofarmaceutike Nr.83/12_dhe Gazeta Zyrtare Nr.35/23, 27 Mars 2023. Qëllimi i këtij ligji është që FFS të përdoren në një mënyrë që mundëson zhvillimin e një bujqësie të qëndrueshme dhe konkurruese dhe siguron një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe kafshëve dhe mbrojtjes së mjedisit, futjen e përdorimit të detyrueshëm të mbrojtjes së integruar të bimëve kundër organizmave të dëmshëm. dhe promovimin e qasjeve dhe teknikave alternative në fushën e shtypjes së tyre.

Kapitulli II. VLERËSIMI I SUBSTANCAVE AKTIVE DHE REGJISTRIMI I FFS, Neni 5,paragrafi 1 deri 5 paraqet Regjistrimi dhe lejet e FFS, Neni 7 paragrafi 1 deri 9, testet e performancës Neni 8 paragrafi 1-3, tarifat.

Kapitulli III Neni 18, trajtimi i paketimit dhe mbetjeve FFS, ku shpërndarësit dhe përdoruesit e FFS duhet të trajtojnë paketimin dhe mbetjet e FFS në mënyrën e përcaktuar nga rregulloret që rregullojnë menaxhimin e mbetjeve, rregulloret që rregullojnë paketimin dhe mbetjet e paketimit, dhe në rastin e FFS, rregulloret që rregullojnë menaxhimin e mbetjeve FFS që përmbajnë substanca të rrezikshme. Neni 19 rregullon të dhënat e përdorimit të FFS.

Kapitulli V TRAJNIM nga Neni 22, 23, 24, 25 , Neni 22 rregullohet trajnimi i përdoruesit profesionistë, shitësit e FFS dhe konsulentët FFS, si dhe personat e tjerë që dëshirojnë të marrin një certifikatë të përvetësimit të njohurive në fitomjekësi, 23 Administrata zgjedh, në bazë të tenderit publik, për një periudhë pesë vjeçare, ofruesit e trajnimit të përmendur në nenin 22 të këtij ligji të cilët janë persona juridikë ose fizikë dhe janë të regjistruar për të kryer. Zhvillon veprimtari edukative dhe plotëson kushtet në lidhje me mjediset dhe pajisjet teknike, si dhe të ketë të paktën një pedagog në marrëdhënie pune ose kontraktuale për secilën nga fushat profesionale të fitomjekësisë, i cili është i njohur me përmbajtjen dhe programin e trajnimit në fushën e fitomjekësisë dhe plotëson. kushtet nga neni 24 i këtij ligji. Neni 25, Trajnimi për trajtimin e FFS nga paragrafi i parë i nenit 22 të këtij ligji, përfshinë trajnimin bazë dhe atë të mëtutjeshëm. Neni 26, ofruesit e trajnimit i jepet certifikata nga Administrata.

Kapitulli VI. PAJISJET E APLIKIMIT FFS nga Neni 27, 28 deri te Neni 29, ky kapitull rregullon kontrollin dhe certifikimin e paisjeve. Neni 35 mbrojtja e integruar e bimëve kundër organizmave të dëmshëm, Kapitulli IX. DETYRA PROFESIONALE, PUNË KËRKIMORE DHE

LABORATORI nga Neni 38, 39 si dhe Kapitulli X. MBLEDHJA E TË DHËNAVE, PËRTRITJA DHE PËRDORIMI I TË DHËNAVE

**Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme**
*Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit*

| Kategoritë e ndikimeve | Ndikimet përkatëse të identifikuara |
|---|---|
| **Ndikimet ekonomike** | Ndikim në qasjen në financa për biznes;<br>Largohen nga tregu produkte të caktuara (jo cilësore);<br>Lejohen në treg produkte të caktuara (cilësore);<br>Do të krijohen biznese të reja. |
| Ngarkesa administrative | Thjeshtësim i detyrimeve për dhënien e informatave për bizneset. |
| Tregtia | Ndryshim në flukset aktuale të importit. |
| Investimet | Pritje nga kompanitë të investojnë në veprimtari të reja;<br>Rritje e investimeve nga diaspora;<br>Rritje e investimeve të huaja direkte. |
| Konkurrueshmëria | Promovim i inovacionit dhe hulumtimit. |
| Ndikimet ekonomike rajonale | Ndikim në sektorë të veçantë të biznesit. |
| Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik | Ndikim në rritjen e ardhshme ekonomike. |
| **Ndikimet shoqërore** | Ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. |
| Qeverisja | Trajtimi i çdo personi në mënyrë të barabartë;<br>Informim më mirë i publikut në lidhje me çështje të caktuara. |
| Shëndeti dhe siguria publike[1] | Ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë; |

[1] Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

| | |
|---|---|
| | Ndikim në cilësinë e ushqimit. |
| **Ndikimet mjedisore**<br>Mirëqenia e njeriut | Ndikim në shëndetin e njerëzve;<br>Ndikim në cilësinë dhe sigurinë e ushqimit të njerëzve. |
| **Ndikimi në të drejtat themelore**<br>Trajtimi i barabartë | Ndikim në mbrojtjen e opsionit për parimin e barazisë para ligjit. |
| Administrimi i mirë | Ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.). |

## NDIKIMET EKONOMIKE

**Ndikimi në qasjen në financa për biznes**

Me vendosjen e këtyre politikave apo me hartimin e Ligjit të ri të PMB-ve do të synohet përmirësimi i tregut me PMB cilësore, të cilat pa dyshim do të kenë efekt në ruajtjen e shëndetit të njeriut, kafshëve dhe bimëve. Me këtë politikë një pjesë e produkteve bujqësore do të jenë konkurruese në treg për nga aspekti i cilësisë dhe sigurisë ushqimore.

**Largimi nga tregu i produkteve të caktuara**

Minimizimi i qarkullimit dhe përdorimit të PMB-ve jo cilësore, është i varur nga importi dhe tregtia e PMB-ve cilësore dhe vendosja e tyre në treg, të cilat do të kenë ndikim në largimin e PMB-ve me cilësi të dobëta nga tregu dhe mospërdorimi i tyre nga ana e fermerëve prodhues.

**Lejimi në treg i produkteve të caktuara**

Lejimi i tregtimit të PMB-ve do të jetë sipas kritereve dhe procedurave standarde të përcaktuar me Ligjin e PMB-ve.

**Krijimi i bizneseve të reja**

Importimi dhe tregtimi i PMB-ve cilësore, mund të nxitë interesimin e bizneseve të reja për të përdorur produkte cilësore, të cilët mund të regjistrohen si operatorë (kompani importuese dhe tregtuese) për PMB.

**Dhënia e informatave për bizneset**

Dhënia e informatave për bizneset, lidhur me të gjitha procedurat dhe kriteret për regjistrimin e një PMB-je në listën e PMB-ve në Kosovë, do të jenë më të thjeshtësuara, duke i informuar palët e interesit (bizneset), përmes shpërndarjes së informacioneve në forma të ndryshme elektronike, përfshirë edhe web faqen e MBPZHR-së.

**Ndryshueshmëria e flukseve aktuale të importit**

Ndryshimi i fluksit të importit aktual të PMB-ve, do të jetë i mundur duke i mbështetur importuesit dhe tregtuesit vendor, të cilët do të mund t'i furnizojnë fermerët me PMB-të cilësore që japin efekt në prodhim dhe cilësi të lartë.

**Investimet e kompanive në veprimtari të reja**

Momentalisht në Kosovë janë disa operatorë ekonomikë të licencuar për importimin dhe tregtimin e PMB-ve, të cilat gjenden në Listën e PMB-ve në Kosovë, megjithatë të njëjtat kompani kanë për synim edhe avansimin e standardeve sa i përket tregtimit, rujtjes, deponimit dhe shpërndarjes të produkteve për mbrojtjen e bimëve. Mirëpo duhet theksuar se zhvillimi i sektorëve tjerë për importimin dhe tregtimin e PMB-ve është i ndërlidhur ngushtë me investimet në rritjen e kapaciteteve profesionale dhe teknike në kompanitë prodhuese të PMB-ve.

**Investimet nga diaspora**

Përmes rrugës ligjore me hartimin e Ligjit të ri për PMB, do të krijohen hapësira për palët që kanë për synim investimet në zhvillimin e sektorit të PMB-ve në vendin tonë, të cilat mund të jenë edhe operatorë të jashtëm nga diaspora të cilët do ta kenë mundësinë e investimeve në sektorin e importimit dhe tregtimit të PMB-ve. Investimet në sektorin e PMB-ve nga diaspora në vendin tonë do të kenë ndikim në ngritjen e standardeve të cilësisë për importimin dhe

tregtimin e PMB-ve duke u bazuar në praktikat e vendeve të ndryshme të botës nga të cilat vijnë investitorët.

**Investimet e huaja direkte**

Investimet e huaja të mëtutjeshme në sektorin e PMB-ve do të jenë të mundshme, sepse aktualisht është e pamundshme mbulimi i tregut tonë me PMB, andaj kjo gjendje mund të nxitë kompanitë e huaja importuese dhe tregtuese të PMB-ve të realizojnë investime direkte në vendin tonë.

**Promovimi i inovacionit dhe hulumtimi**

Hulumtimi dhe identifikimi i PMB-ve me cilësi të lartë dhe të përshtatshme në kushte të ndryshme klimatike do të realizohet përmes analizave laboratorike, si dhe do të krijohen mundësi për promovimin e cilësive të tyre përmes shërbimeve këshillimore tek fermerët.

**Ndikimi në sektorë të biznesit**

Përmirësimi i rregullativës ligjore për PMB-të do të krijojë mundësi për zhvillimin e suksesshëm të sektorit të PMB-ve, duke i krijuar hapësirë bizneseve që importojnë dhe tregtojnë PMB cilësore për fermerët të cilët do të ndikojnë në zhvillimin e suksesshëm të bizneseve në sektorin e PMB-ve.

**Ndikimi në rritjen e ardhshme ekonomike**

Furnizimi i tregut me PMB cilësore do të ketë ndikim në zhvillimin ekonomik në nivel vendi duke pasur efekt në ndikimin e rritjes së prodhimtarisë bimore në vendin tonë.

**NDIKIMET SHOQËRORE**

**Ndikimi në arsimim**

Zhvillimi dhe arsimimi i stafit profesional dhe teknik do të mund të plotësohet përmes ndjekjes së trajnimeve të organizuara nga institucione përkatëse me qëllim përgatitjen e kuadrove profesionale, të cilat do të japin kontributin e tyre në zhvillimin e sektorit të PMB-ve në të ardhmen.

**Trajtimi dhe barazia e individëve**

Personat fizik apo juridik të cilët do të merren me importimin apo tregtimin e PMB-ve, do të jenë të barabartë pa dallime gjinore, përkatësie etnike apo religjioni, duke i respektuar rregullat që do të përcaktohen në Ligjin e PMB-ve.

**Informimi i publikut**

Të gjitha palët e interesuara (publiku), do të jenë të informuar me rregullat apo kriteret të cilat do të paraqiten në Ligjin e ri për PMB-të, i cili do të jetë i publikuar në web faqen e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

**Ndikimi në jetën e njerëzve**

Furnizimi i fermerëve me PMB cilësore nënkupton përdorimin efikas të produkteve me vlera cilësore që ndikon në zinxhirin ushqimore, të cilat produkte bimore padyshim kanë ndikim në ushqyerjen e shëndetshme të popullatës dhe ndikim të jetëgjatësisë.

**Ndikimi në cilësinë e ushqimit**

Nga produktet e fituara do të ketë ndikim në sigurimin e ushqimit primarë për popullatën, dhe sigurinë e cila do të ndikoj në shëndetin e përgjithshëm publik që nënkupton se është interes nacional në vendin tonë.

NDIKIMET MJEDISORE

Përdorimi i vazhdueshëm i PMB-ve ka ndikim në ndotjen e tokës dhe ujit, si pasojë e akumulimit të mbetjeve kimike të cilat mund ta ndryshojnë ekosistemin.

**Ndikimi në cilësinë dhe sigurinë e ushqimit**

Përmirësimi dhe menaxhimi i sistemit të kontrollit të PMB-ve në treg, nënkupton sigurimin e PMB-ve cilësore nga të cilat do të fitohen produkte të shëndetshme bimore me vlera të larta ushqyese, të cilat do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e shëndetit të njeriut, kafshëve dhe bimëve.

## TË DREJTAT THEMELORE

**Parimi dhe barazia**

Garancitë ligjore dhe dispozitat shoqërore do të sigurojnë të drejta të barabarta për të gjitha palët.

**Ndikimi në të drejtat themelore dhe administrimi i mirë**

Me përmirësimin e kësaj politike, procedurat administrative do të jenë më transparente, do të eliminohen procedurat e tepërta burokratike dhe të përcaktohen afatet procedurale për zgjidhjen e lëndëve.

**Të dhënat personale** – do të ketë ndikim / ndryshime në të drejtat e individëve dhe te dhënave personale.

**Opsioni 1,** nuk është i dëshirueshëm për shkak të pasojave potencialisht për regjistrimin, tregtimin dhe përdorimin e PMB-ve me kornizën aktuale ligjore. Zgjedhja e këtij opsioni do të nënkuptonte pranimin e mungesës së qasjes koherente dhe gjithëpërfshirëse në fushën e mbrojtjes se bimeve respektivisht PMB-ve.

Objektivat kryesore, PMB-të publik nuk do të arriheshin, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë akterëve të përfshirë në sektroin e PMB-ve do të vazhdojnë të mos jenë të qarta dhe do të ketë fokus të pamjaftueshëm lidhur me PMB-të.

Ky opsion nuk ofron mundësi, as për arritjen e objektivave sa i takon zvogëlimit të barrës administrative, pasiqë ai nuk parasheh kurrfarë intervenimesh.

**Opsioni 2,** do të kishte përmirësim dhe qartësi të lehtë të dispozitave për PMB-të nga njëra anë, por pa adresuar opsionet e politikave dhe zhvillimet e përcaktuara në Kapitullin 1 të këtij dokumenti. Përfitimet që lidhen me këtë opsion janë vetëm se do të ketë më shumë sqarime të rregulluara me legjislacion. Duke bashkuar të gjithë legjislacionin ekzistues në një vend, do të kishte një thjeshtësi të përmirësuar për palët me interes që kërkojnë legjislacionin me të cilin do të kuptonin detyrimet e tyre. Nëse zgjidhet opsioni 2, do të humben mundësi kyçe për të adresuar mangësitë e plota në legjislacionin aktual dhe problemet për shkak të mungesës së politikave të përgjithshme siç përshkruhet në këtë dokumenti, në veçanti fokusi i pamjaftueshëm lidhur me PMB-të.

Intervenimet e kufizuara të parapara në këtë opsion, sa i takon barrës administrative, do të ofronin efekte sipërfaqësore sa i takon zvogëlimit të barrës ligjore. Pamundësia e ndryshimeve ligjore, nuk lejon thjeshtimin e procedurave, uljen e taksave, por edhe shkurtimin e kohës për shërbime. Për më tepër, korniza e tanishme ligjore nuk promovon komunikimin elektronik, gjë që vështirëson edhe më tej përpjekjet për digjitalizim, i cili paraqet mjetin më të përshtatshëm për zvogëlim të barrës administrative.

**Opsioni 3**, parashikon krijimin e kornizës rregullative, horizontale, transparente, gjithëpërfshirëse dhe të qartë të bazuar në qeverisjen e mirë dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, të fokusuar në masat parandaluese afatgjate, siç parashikohet nga Rregullorja (BE) Nr. Nr.1107/2009. Ky opsion pritet të ketë ndikim më të qartë dhe direkt, sepse do të mundësojë ndryshime legjislative në politikën e PMB-ve dhe ofron fleksibilitet më të madh dhe barrë administrative më të ulët.

Ndikimet ekonomike priten të jenë pozitive. Së pari, janë përfitimet e pritshme nga reduktimi i shkallës së MML- Mbetjet Maksimale të Lejuara dhe përmirësimi i gjendjes shëndetësore të bimëve në vend, për sa i përket përfitimeve të drejtpërdrejta financiare nga reduktimi i paraqitjes së agjenteve te demshem biologjik. Përmirësimi i gjendjes së shëndetit të bimëve do të kontribuojë gjithashtu në përmirësimin e prodhimeve bujqësore vendore nëpërmjet vlerës më të lartë të prodhimit dhe mundësive të reja të punësimit.

Megjithëse nuk mund të pritet rritje e lartë e punësimit, supozohet se shkalla e punësimit do të rritet lehtësisht me ndikim më të fortë në terma afatgjatë. Pritet që të kërkohet më shumë staf i kualifikuar, por edhe në këtë rast efektet do të shihen në planin afatgjatë. Rrjedhimisht, stafi i trajnuar profesionalisht dhe i avancuar mund të marrë paga më të larta.

Njohuritë për PMB-të do të duhej të përqendrohen në përmirësimin e informacioneve lidhur për rrezik më të lartë për shëndetin e njerzëve, kafshëve dhe mjedsin nga PMB-të e reja.

Për më tepër, detyrimet për operatorët janë shumë më të qarta dhe që në terma afatgjatë lehtësojnë procedurën e administrimit. Këto ndryshime në politikën e PMB-ve do të kenë efekt në përmirësimin e gjendjes në këtë sektor që kontribuojnë në radhë të parë në vlerën më të lartë të prodhimit dhe konkurrencës, duke rritur kështu mundësitë e reja që kanë efekte në treg. Opsioni i propozuar do të lehtësojë procesin e regjistrimit, tregtimin dhe përdorimin e PMB-ve.

Gjithashtu, tek bizneset do të ketë efekt pozitiv për investime vendore dhe të huaja, për shkak të situatës më të mirë te sektorit te PMB-ve në vend. Në përgjithësi, rritje ekonomike pozitive pritet të përcaktohet nga produktiviteti më i lartë dhe potenciali i rritjes së prodhimeve bujqësore vendore. Kontributi i pritshëm në ekonomi pritet të jep efekt duke ulur importet dhe rritur kontributin në uljen e mundshme të inflacionit.

Ndikimi do të jetë pozitiv, për sa i përket përfitimeve nga arritja e standardeve të qëndrueshëm për PMB-të. Kjo në terma afatgjatë mund të kontribuojë në përmirësimin e prodhimtarisë bujqësore dhe në zbutjen e varfërisë në zonat rurale nëpërmjet vlerës më të lartë të prodhimit dhe mundësive të reja të punësimit.

Edukimi i fermerëve për përdorimin e qëndrueshëm të PMB-ve duhet që të orientohet në njohuri adekuate për PMB-të, parimet e biosigurisë, ndërveprimi ndërmjet PMB-ve dhe shëndetit të njeriut, praktikat e mira për përdorim të qëndrueshëm dhe mbrojtje te mjedisit.

Në anën tjetër, ky opsion parasheh ndryshime ligjore, na lejon të harmonizojmë dispozitat rreth ofrimit të shërbimeve me kërkesat e LPPA, gjë që do të shpie në rregullimin e tarifave, por edhe në përmirësimin e sherbimeve sa i përket kohës. Për më tepër, ndryshimet ligjore na mundësojnë të zhvillojmë procedura, gjë që do të na lejojë t'i digjitalizojmë plotësisht shërbimet në fjalë, në një të ardhme të afërt. Ky opsion ofron adresim të drejt sa i takon barrës administrative.

**Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi**
*Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument*

Procesi i konsultimit synon:

- [Jepni informacionin këtu:
- [Kur KD-ja dërgohet për konsultime publike, kolona për buxhet duhet të fshihet];
- [Kur KD-ja dërgohet për konsultime publike, titulli i kolonës 'Afati Indikativ' duhet të ndryshohet në 'Afati kohor'].

| **Qëllimi kryesor** | **Grupi i synuar** | **Aktiviteti** | **Komunikimi/njoftimi** | **Afati indikativ** | **Buxheti i nevojshëm** | **Personi përgjegjës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Konsultimi për definimin e problemit. | Të gjitha palët e interesuara. | Takimi i parë publik. | Njoftimi i dërguar përmes postës elektronike zyrtare. | 00.00.00 | MBPZHR | Selvije Blakaj-Gashi |
| Konsultimi paraprak ndërministror. | Incitucionet relvante sipas nenit 7 të Rregullores së punës së Qeverisë. | Dërgimi i draft KD. | Përmes postës elektronike zyrtare. | | | |
| Konsultimi publik me shkrim. | Incitucionet relevante, palët e interesuara. | Publikimi i draft KD në portalin e konsultimeve publike. | Publikimi në web faqe dhe në llogarinë e facebookut të MBPZhR-së dhe njoftimi për mediat vendore. | | | |

**Përmbledhje nga aktivitetet publike për Koncept Dokumentin**

1. Organizimi fillestar me palët me interes **12.05.2023,** ftesat për pjesëmarrje janë dërguar tek këto institucione: MBPZHR, AUV, Fakultetet e Bujqësisë, Doganës, si dhe Shoqata per Impute Bujqesore
2. Ndërkaq, ftesës për pjesëmarrje i janë përgjigjur këto institucione: Shoqata per Impute Bujqesore,Fakulteti i Bujqesie dhe Doganat
3. Grupi punues ka prezantuar para pjesëmarrësve fillimin e punës së Koncept Dokumentit, i cili ka për qëllim krijimin e një politike për menaxhimin dhe kontrollin më të mirë të PMB-ve në përgjithësi, të cilat importohen dhe tregtohen nga jashtë në Kosovë.
   Gjatë takimit me palët e interesit u rekomandua që të gjitha propozimet e tyre t'i përcjellin përmes e-mail adresave të tyre.

2. Konsultime paraprake ndërministrore nga data: ///

3. Publikimi në platformën online nga data: ///,

Njoftimi për këtë në rrjetin social Fcb të MBPZHR-së, e bashkë me këtë edhe hartimi i njoftimit (lajmit) për web faqen e MBPZHR-së dhe media.

Të gjitha publikimet në media që lidhen me temën e koncept dokumentit do të bashkëngjiten përmes linqeve në këtë koncept.

**Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve**

<u>Opsioni 1</u>, nuk është i dëshirueshëm për shkak të pasojave potencialisht sa i përket regjistrimit, ri-regjistrimit, tregtimit dhe përodirimit të PMB-ve me kornizën aktuale ligjore. Mos ndryshimi i gjendjes aktuale sipas këtij opsioni, do të vazhdoj që objektivat për PMB-të të mos arrihen. Për më shumë përgjegjësitë e akterëve të përfshirë në sektroin e PMB-ve do të vazhdojnë të mos jenë të qarta lidhur me regjistrimin, ri-regjistrimin, tregtimin dhe përodirimin e PMB-ve.

<u>Opsioni 2</u>, do të kishte përmirësim dhe qartësi të lehtë të dispozitave për PMB-të, por pa adresuar opsionet e politikave. Sipas këtij opsioni do të ketë më shumë sqarime të rregulluara me legjislacion dhe përmirësim për palët me interes me të cilin do të kuptonin detyrimet e tyre.

<u>Opsioni 3</u>, parashikon Projektligjin e ri në përputhje me standardet ndërkombëtare, të fokusuar në masat parandaluese afatgjate, siç parashikohet nga Rregullorja (BE) Nr.1107/2009. Ky opsion do të ketë ndikim më të qartë në politikën e mbrojtjes së bimëve, respektivisht PMB-ve, ofron fleksibilitet më të madh dhe barrë administrative më të ulët. Politikat për mbrojtjen e bimëve, respektivisht PMB-ve do të kontribuojnë në vlerën më të lartë të prodhimit dhe konkurrencës, duke rritur kështu mundësitë e reja që kanë efekte në treg.

Opsioni i propozuar ka ndikim të drejtpërdrejt nga reduktimi i ndikimit të PMB-ve në shendetin e njerzëve, kafshëve dhe ndotjen e mjedisit. Çdo reduktim në shendetin e njerzëve, kafshëve dhe ndotjen e mjedisit do të reduktonte rrjedhimisht rreziqet lidhur për shëndetin publik. Pra, ndikimi do të jetë pozitiv, për sa i përket përfitimeve nga arritja e standardeve të qëndrueshëm për shendetin e njerzëve, kafshëve dhe ndotjen e mjedisit dhe plotësimin e standardeve të qëndrueshme për PMB-të.

Edukimi i fermerëve për përdorimin e drejtë të PMB-ve do të orijentohet në njohuri adekuate PMB-të, parimet e biosigurisë, ndërveprimi ndërmjet PMB-ve dhe bimëve, shëndetin e njeriut dhe kafshëve dhe praktikat e mira për përdorimin e PMB-ve.

<u>Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme</u>

Për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Ligji për PMB-të dhe adresimin e disa shkaqeve të problemit, **Opsioni 3** parasheh:

- Krijimin kornizës rregullative gjithëpërfshirës në përputhje me standardet ndërkombëtare, të fokusuar në masat parandaluese afatgjate, siç parashikohet nga Rregullorja (BE) Nr.1107/2009;
- Rritjen e të hyrave buxhetore;

- Ofron fleksibilitet më të madh dhe barrë administrative më të ulët;
- Politikat për përmirësimin e gjendjes së mbrojtjes se bimeve, respektivisht PMB-ve do të kontribuojnë në vlerën më të lartë të prodhimit dhe konkurrencës, duke rritur kështu mundësitë e reja që kanë efekte në treg;
- Reduktimin e PMB-ve që do të reduktonte rreziqet për shëndetin e njerzëve, kafshëve dhe mbrojtjen e mjedisit dhe plotësimin e standardeve të qëndrueshëm për PMB-të;
- Edukimi i feremreve te PMB-ve do të orijentohet në: per perdorim te drejte, parimet e biosigurisë, ndërveprimi ndërmjet PMB-ve dhe shëndetit të njerzëve, kafshëve dhe mjedisit;
- Rritjen e buxhetit dhe angazhimin e inspektorëve shtesë për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për PMB-të.

Plani i zbatimit për Opsionin 2

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qëllimi i Politikës** | Opsioni 2 parashikon krijimin kornizës rregullative gjithëpërfshirës në përputhje me standardet ndërkombëtare, të fokusuar në masat parandaluese afatgjate, siç parashikohet nga Rregullorja (BE) Nr.1107/2009. Ky opsion do të ketë ndikim më të qarta në politikën e PMB-ve, ofron fleksibilitet më të madh dhe barrë administrative më të ulët. | | | | | | | | **Shifra e kostos së pritur** |
| **Objektivi strategjik** | - Avancimi i politikave për siguri ushqimore dhe përafrimi i tyre me standardet e BE-së, të cilat synojnë të sigurojnë një nivel të lartë të ushqimit për njeriun dhe shëndetin e bimëve nga përdorimi i qëndrueshëm i produkteve për mbrojtjen e bimëve. | | | | | | | | |
| | Produkti, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës. | | | | | | | | |
| **Objektivi Specifik Nr.1** Regjistrimi, importimi, ruajtja dhe vendosja në treg e PMB-ve të bëhet sipas legjislacionit | **Produkti 1.1** | **Koordinimi më i mirë institucional në mes të nivelit qendror dhe palëve me interes** | | | | | | | |
| | | | | | | | | Institucioni /departamenti përgjegjës | |
| | | **Aktiviteti 1.1.1** Pregatitja e Vendimit dhe | X | X | X | X | X | MBPZHR DPBT / | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| të BE-së. | | Certifikata për autorizim.Krijimi i databazës për PMB-të e regjistruara. | | | | | | | |
| **Objektivi Specifik Nr.2** Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit për PMB-të dhe inspektimit pas regjistrimit. | **Produkti 2.1** | **Koordinimi më i mirë institucional në mes të nivelit qendror (MBZHR, IBK, AUV dhe institucionet tjera relevante)** | | | | | | | |
| | | | Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 | Viti 4 | Viti 5 | Institucioni /departamenti përgjegjës | |
